



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr.1031/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbaremore të kreditorit “E...F...” Sh.P.K., me numër të biznesit ... dhe seli në ..., Komuna e Lipjanit, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit N.T., avokat nga Lipjani, kundër debitorit “L...” Sh.P.K., me numër unik identifikues ... dhe seli në Prishtinë, ..., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit K.O., avokat nga Mitrovica, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbaremore P.nr. 32/21, i lejuar me datë 04.02.2021, nga Përmbareuesi Privat Driton Govori, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 28.04.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “L...” Sh.P.K., me numër unik identifikues ..., ashtu që Urdhri Përmbaremore P.nr. 32/21, i lejuar me datë 04.02.2021, nga Përmbareuesi Privat Driton Govori, ANULOHET.
- II. DETYROHET kreditori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e prapësimit, t’ia paguaj debitorit shumën prej EUR 104.00 € (njëqind e katër Euro), në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit mbi bazën faturës nr. 003-021-001013/19, e datës 12.10.2019, ka lejuar urdhrin për përmbaremore P.nr. 32/21, të datës 04.02.2021, me të cilin është urdhëruar debitori që në emër të faturës, t’ia paguaj kreditorit shumën prej EUR 5,142.64, si dhe shpenzimet në emër të përpilimit të propozimit në lartësi prej EUR 156.00.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 18.03.2021, ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbaremore me arsyetim se mes kreditorit dhe debitorit nuk ekziston kurrfarë raporti afarist, duke shtuar se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri nuk është pranuar asnjëherë nga debitori dhe se e njëjta është e

panëshkruar dhe e pavulosur, dhe rrjedhimisht e njëjta nuk është e përshtatshme për përmbartim. Tutje, ka theksuar se urdhri për lejimin e përmbartimit është i parregullt për shkak se i mungon baza juridike, ngase i njëjti mbështetet në dokument të falsifikuar, të pa vulosur apo nënshkruar nga debitori. Në fund, gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj si të bazuar prapësimin e debitorit, urdhri përmbartimor të anulohet dhe të obligohet kreditori që t'ia paguaj debitorit shpenzimet në emër të përpilimit të prapësimin, në vlerë prej EUR 156, konform rregullores mbi tarifatat e avokatëve.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka paraqitur përgjigje në prapësimin ku fillimisht ka theksuar se prapësimi i debitorit është paraqitur jashtë afatit ligjor. Ndërsa, ka shtuar se arsyet e debitorit të paraqitura në prapësimin nuk qëndrojnë ngase kreditori nuk pretendon në borxh të paqenë. Tutje, ka theksuar se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri është në harmoni me dispozitat e LPP-së, ndërsa prapësimi i debitorit nuk i përmbush shkaqet nga neni 69 dhe 71.1 të LPP-së. Në fund, ka shtuar se kreditori është munduar që debitorit ti ofroj kushte rreth pagesës së borxhit mirëpo që debitori i është shmangur takimeve me kreditorin dhe nuk është përgjigjur fare. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit, ashtu që urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi. Poashtu, i ka kërkuar shpenzimet në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësimin, në lartësi prej EUR 156.00, konform rregullores mbi tarifatat e avokatëve.

Ndërsa, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësimin, përgjigjes së kreditorit në prapësimin, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (në tekstin e mëtejshëm: “LPP”) gjykata gjen se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së: “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa, pika 1.3 e njejtij nen ka përcaktuar faturën si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, në paragrafin 3 të këtij neni është përcaktuar se: “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shumata dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”. Në anën tjetër, me nenin 37 të LPP-së parashihet se: “Kur propozimi për

*përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.*

Gjykata, duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm, ngase nuk mund të vërtetohet që e njëjta është dorëzuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit dhe se është pranuar nga debitori, për arsye se të njëjës i mungon nënshkrimi apo vula e pranimi të debitorit. Në anën tjetër, kreditori nuk ka arritur të dëshmojë se në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme ia ka dorëzuar debitorit faturën mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri, ndërsa ky i fundit të njëjtën e ka pranuar dhe është njoftuar me detyrimin që buron nga fatura. Rrjedhimisht, një faturë lëshuar nga kreditori, mirëpo e papranuar nga debitori përbën dokument të njëanshëm dhe, si e tillë, nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm.

Poashtu, gjykata gjen se dokumenti, përkatësisht fatura në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarrim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm në kuptim të nenit 37 të LPP-së, ngase e njëjta është deponuar në kopje dhe jo origjinali i saj apo kopja e vërtetuar pranë organit kompetent.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarrim, e mbi bazën e të cilit Përmbarruesi privat ka lejuar përmbarrimin, nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbarruesit duhet të anulohet.

Lidhur me shpenzimet, gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi duke ju referuar dispozitave nga neni 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet debitori për përpilimin prapësimi, dhe atë në shumën prej EUR 104.00 € (njëqind e katër Euro), konform rregullores mbi tarifën e avokatëve.

Nga sa më sipër, gjykata në kuptim të nenit 71, paragrafi 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1031/22, datë 28.04.2023

Gjyqtari

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.